



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3099/ 12 prot.

Datë 29/12/2025

V E N D I M

Nr. 1920/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29/12/2025, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1837/2025, datë 11.12.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-61164-09-11-2025, me objekt: “Kryerje e shërbimit të Gjellbërimit në SUT” për një periudhë 36 mujore”, me fond limit 32,115,167.55 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Ankimues: Operatori ekonomik “Alb Garden” SHPK me NIPT K37513520N dhe adresë: Lagjja “Skenderbeg”, godine 2 private 1 katëshe në superstradën Lezhe - Shkodër, km 1.

Operatori ekonomik “Rej” SHPK, me NIPT J93711608Q dhe adresë: Rruga “Dritan Hoxha”, ngjitur me Shkolën “Ahmet Gashi”, Kulla Jeshile Nr.Pasuri 8/374 /ND+3-6, Hyrja 3, Apartament Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqendruara
Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

Subjekte të interesuar: Operatori ekonomik “Asi Invest” SHPK me NIPT M01927023H dhe adresë: Rruga Koke Malci, nr pasurie 4/49/ND Burrel,Mat.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:**I****Rrethanat e çështjes**

I.1. Në datë 11.12.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1837/2025, ku vendosi:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “AlbGarden” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-61164-09-11-2025, me objekt: “Kryerje e shërbimit të Gjelbërimit në SUT” për një periudhë 36 mujore”, me fond limit 32,115,167.55 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “Asi Invest” SHPK, duke e skualifikuar atë në zbatim të vendimit të KSHA nr.129/2025, datë 11.11.2025.
3. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Rej” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.
4. Autoriteti kontraktues të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim
5. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “AlbGarden” SHPK dhe operatori ekonomik ‘Rej’ SHPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 2811/4/1 prot., datë 16.12.2025, protokolluar me tonën nr. 3099/9 prot, datë 18.12.2025, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara, lidhur me zbatimin e Vendimit Nr. 1837/2025, datë 11.12.2025, njofton se ka zbatuar vendimin e sipërpërmendur, duke skualifikuar ofertën e operatorit ekonomik “Asi Invest” SHPK, si dhe duke rivlerësuar ofertën e operatorit ekonomik “*REJ*” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. *REF-61164-09-11-2025*, me objekt: “*Kryerje e shërbimit të Gjellbërimit në SUT*” për një periudhë 36 mujore”, me fond limit 32,115,167.55 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 2811/4/1 prot., datë 16.12.2025, protokolluar me tonën nr. 3099/9 prot, datë 18.12.2025, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara, lidhur me zbatimin e Vendimit Nr. 1837/2025, datë 11.12.2025, njofton se ka zbatuar vendimin e sipërpërmendur, duke skualifikuar ofertën e operatorit ekonomik “Asi Invest” SHPK, si dhe duke rivlerësuar ofertën e operatorit ekonomik “*REJ*” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. *REF-61164-09-11-2025*, me objekt: “*Kryerje e shërbimit të Gjellbërimit në SUT*” për një periudhë 36 mujore”, me fond limit 32,115,167.55 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara..

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe verifikimeve të bëra në systemin e prokurimeve elektronike (SPE) konstatohet se autoriteti kontraktor ka rivlerësuar procedurën e prokurimit, duke skualifikuar ofertën e operatorit ekonomik “Asi Invest” SHPK, si dhe duke rivlerësuar ofertën e operatorit ekonomik “*REJ*” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit sipas përcaktimeve të Vendimit K.P.P Nr. 1837/2025 datë 11.12.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. *REF-61164-09-11-2025*, me objekt: “*Kryerje e shërbimit të Gjelbërimit në SUT*” për një periudhë 36 mujore”, me fond limit 32,115,167.55 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

